


Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | |
|--|--|---|
|  <i>Visar BIBAJ – Exp. Shqyrtues</i> | <i>Data e autorizimit të ekspertit</i> 21.12.2020 | <i>Data e dorëzimit të raportit</i> 28.12.2020 |
|--|--|---|

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.12.2020, OE “Quality Asphalt”shpk - Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: 1122/20, , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ne lot 1, (pas ri vlerësimit te ofertave) lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i rrugëve ne pjesët rurale me infrastruktur përcjellëse”, me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, (Lot 1), iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtine.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, të negociuar, të kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,290,000.00 €.

Paneli Shqyrtues me datën 16.11.2020, ka nxjerr vendim per kete AP, me nr. 858/20

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Ak, sipas Oe ankues:

Neni 7, 59, 60, 61, 69, 72 dhe 108/A, te LPP-se, neni 39.8, te RrUOPP-se, si dhe neni 11, te ligjit 03/L-212.

Deklarata Detale

AK-Komuna e Prishtines per aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i rrugeve ne pjeset rurale me infrastrukture percjellese " — LOT 1, ka shperblyer me kontrate nje OE i cili nuk i ploteson kriteret e kerkuara sipas FDT-se dhe Njofimit per kontrate.

Pretendimi ankimor nr.1

AK ka bere shkelje te nenit 72 te LPP-se dhe Nenit 39.8 te RrUOPP-se sepse i ka kerkuar sqarime OE se rekomanduar pa te drejte ligjore.

AIK ka bere shkelje pasi qe ka shperblyer me kontrate OE te papergjegjshem, sepse OE i rekomanduar nuk i ploteson kriteret e kerkuara sipas FDT-se, por nuk qendron arsyetimi i AK-se se ka pas te drejte per me kerku CV tjeter por duhet te kerkoj sqarime lidhur me CV-ne qe e ka dorezuar ne dosje me dt.13.07.2020 ejo te kerkoj CV tjeter, kete shkelje e precizon shume qarte edhe neni 39.8 i RRUOPP-se ku thote se:

| | | |
|---|---|---------------------|
| Mnngon certifikata ISO | Mund te kerkohen informala sqaruese | 69 |
| Mungon çmimi | Refuzo tenderin pa kerkuar infonnacion të mëtejshëm | Kusht administrativ |
| BCV-ja e dorëzuar nuk Jpërbush kërkesat | Refuzo lenderin pa kerkuar infomacion të mëtejshëm | 69 |
| CV-ja e kerkuar nuk është dorëzuar | Mund te kerkohen informata sqaruese | 69 |
| CV-ja e dorëzuar nuk përmban informata e kerkuar, AK nuk mund te vendos | Mund te kerkohen informala sqaruese | 69 |

Pra, CV e dorezuar per inxhinieren nuk i ploteson kriteret e kerkuara sipas FDT dhe Njofimit per kontrate andaj Ak ka qene dasht ta eliminoj OE "Kema Company" e jo ta shperblej me kontrate sic ka vepruar, sepse inxhinierja Saxhide Ajdini nuk e ploteson kriterin e kerkuar 2 vite pervoje pune sepse kriteri i AK-se ka qene: Dy (2) Inxhinier ose baçelor te ndërtimtarisë (konstruktiv ose infrastrukture) me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot.

Deshmia:

Per inxhinieret e kerkuar duhet deshmuar CV-a, Diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrveshja mbi angazhimin per kete projekt. Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi per menaxher i projektit, ndersa per punetoret e paraqitur ne administraten tatimore te kosoves, deklarate nga OE se posedon 30 punetore te paraqitur ne ATK.

Pra, ne rastin konkret ky OE eshte i papergjegjshem sepse nuk permbushet kriteri i kerkuar 2 vite pervoje pune.

Deshmi CV e dorezuar ne AK per inxhinieren Saxhide Ajdini, e cila me sqarime shtese te AK-se nuk pranohet te nderrohet komplet CV-ja dhe ti shtohet pervoja e punes, por Ligji thote se duhet te kerkohet sqarime nese I. Nuk e ka dorezuar CV-ne, ose 2. Te kerkohet ndonje sqarim lidhur me pervojen, por jo jashte pasqyres apo CV-se se dorezuar. Qe ne kete rast AK i ka kerkuar sqarime shtese qe OE ka ofruar te dhena te rreme sepse pas dorezimit te sqarimeve OE i ka paguar kontributet per 2 vite, e te cilat kontribute jane paguar me dt.Ol.12.2020 qe dmth. 5 muaj pas hapjes se tenderit, qe bie ndesh me nenin 72.3 te LPP-se, qe do te thote qe dokumentet duhet te jene me date para hapjes e jo si ne

rastin konkret pas hapjes duke u munduar te mashtroj se kinse ka punuar me heret ne kompanit tjera dhe duke ia rritur pervojen pa te drejte ligjore CV e dorezoar ne **DOSJE** me dt.13.07.2020

PERSGNAI iNroi^MAncN SAXf 11DIH R AJD IN1



tTUPHISHI
PR HSHTINJ
INITIALS

V STK laAfICH I T1WJ, P«8»NKGO. IQIXMJ PRISI IIINC (Knsnvn)
0 +30e4SBGa/76
FS3 iinxlikfejF^ioimuJl.caii

Sfffc Foinaln | Cilteo' h i V •« 1?.'Ci7/fZl3 J HafcOiiily Kokovhi

Ne referencen e leshuar nga OE. "Floring" rne sqarime shtese qe i ka derguar ne AK edhe pse s'ka pasur te drejte te ndryshoj CV-ne. dhe te dergoj Referenca te cilat nuk e permbushin CV e dorezuar, këtu deshmohet edhe mashtrimi i radhes, sepse ne CV e dorezuar thuhet se vazhdon te punoj ne kompaninë FLORING, kurse ne Referencen thuhet se eshte bashkepunetore e jashtme si ne CV per periudhen 5 mujore.

Ne REFERENCEN e leshuar pa date (ku shihet se eshte manipuluar sepse REFERENCE pa date nuk ka), per inxhinieren Saxhide Ajdini nga OE Floring thuhet Saxhide Ajdini ka qene e angazhuar ne kompanine tone si bashkepunetore e jashtme ne cilesin e inxhinieres se Ndertimtarise konstruktive qe nga dt.01.05.2018 deri 28.09.2018 gjate projektit si ine poshte: Ndertimi i stadiumit ne Viti, nr.prokurimit 657-17-3224-5-1-1, Komuna e Vitise Pra, arsyetimi mashtrues i tyre ka vene ne lajthitje Komunen e Prishtines qe Komuna e Prishtines nuk e ka shqyrtuar sic duhet kerkesen per rishqyrtim per inxhinieren Saxhide Ajdini, pasi qe ia kemi deshmuar se data e transaksionit te kontributeve eshte me 01.12.2020, qe i bie pas dates se hapjes se ofertave, andaj kjo e ben oferten e OE se rekomanduar si te papergjegjshme.

Deshmi: CV e dorezuar ne Dosjen e tenderit deklarone se eshte punetore vetem ne "BEREQETIING" e nuk e deshmon se eshte punetore ne kompani tjera.. Poashtu ne Dosjen e tenderit mungon deldarata me shkrim se duhet te kete se paku 30 punetore,

Deshmia:

Per inxhinieret e kerkuar duhet deshmuar CV-a, Diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marreveshja mbi angazhimin per kete projekt. Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi per menaxher i projektit, ndersa per punetoret e paraqitur ne administraten tatimore te kosoves, deklarate nga OE se posedon 30 punetor te paraqitur ne ATK.

Pra, ne rastin konkret ky OE eshte i papergjegjshem sepse nuk permbushet kriteri i kerkuar 2 vite pervoje pune.

pra, Neni 39.8 i RrUOPP-se thote: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Neni 69

Pra, sipas RrUOPP-se oferta e tij është e papërgjegjshme edhe në këtë pikë

Pretendimi ankimor nr.2

AK ka shkelur edhe nenin 69 të LPP-se, sepse OE i rekomanduar nuk e përmbush nenin 69 të LPP-selidhur me kontratat e punetoreve sepse janë pa vlera/paga, pa data të fillimit pra, janë drafte kontrata që nuk e plotësojnë kriterin e kërkuar të AK-se: Kërkesa:

2. OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon o Udhëheqës i punishtës - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë (Menaxher i Projektit)- min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë). Udhëheqësi i punishtës duhet të ketë udhëhequr kontrata të ngjajshme në vlerën e parashikuar për lotin I dhe VII. o Udhëheqës i punishtës - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë (Menaxher i Projektit) - min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë). Udhëheqësi i punishtës duhet të ketë udhëhequr se paku 1 (një) kontratë në vlerën e parashikuar.- për Loton II,III,IV,V,VI dhe VII-te.
o Një (1)inxhinier ose bachelor i diplomuar i gjeodezisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot.
o Dy (2) Inxhinier ose bachelor të ndërtimtarisë (konstruktiv ose infrastrukturë) me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot
Një (1) inxhinier i diplomuar i hidroteknikës me se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i hidroteknikës me se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot.

Dëshmia:

Për inxhinieret e kërkuar duhet dëshmuar CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lemin e kërkuar të leshuar nga punëdhënësi për menaxherin e projektit, ndërsa për punetoret e paraqitur në administratën tatimore të Kosovës, deklarata nga OE se posedon 30 punëtorë të paraqitur në ATK Pra, OE i rekomanduar me stafin nuk ka kontratë të punës, por ka DRAFT KONTRATË, nuk e ka kontratë ose nuk ka marrëveshje, por janë DRAFT KONTRATË.

Sqarim lidhur me kontratat e bashkangjitura sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm për shkak se:

1. Udhëheqësi i punishtës nuk e ka kontratën me vlerën dhe nuk janë të definuara sipas Ligjit të Punës, nr.03/L-212, neni 11 (përmbajtja e kontratës) i këtij ligji thote: Pika 1.5 Oret dhe orarin e punës - nuk është e definuar në kontratë Pika 1.6 Datat e fillimit të punës Pika 1.8 Lartësia e pages baze, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër

Pretendimi ankimor nr.3

Arben Mazreku - menaxher i projektit, nuk e plotëson kriterin e FDT-se se të ketë referencë për menaxhim të projekteve, por inxhinieri në fjalë ka vetëm mbikqyrjes, organizimit të punimeve. Pra askund nuk dëshmon se ka qenë menaxher i projektit, që kriteri i AK-se ka qenë:
Referenca për punët e mëparshme në lemin e kërkuar të leshuar nga punëdhënësi për menaxherin e projektit.

Pra, AK nuk e ka respektuar kriterin e vet-kërkuar sepse Inxhinieri Arben Mazreku nuk ka Referencë për MENAXHERIN E PROJEKtit, që bie ndesh me kriterin e kërkuar të FDT-se.

Pra, Menaxheri i projektit nuk e plotëson kriterin e kërkuar dhe oferta e OE "Kema Company" behet e papërgjegjshme sipas nenit 59.4 të LPP-së.

Pretendimi ankimor nr.4

Inxhinieri BSc.gjeodezi nuk i ka dy vite përvojë pune pas diplomimit, pasi që nuk i disponon Referencat sipas kriterit dhe poashtu nuk e disponon Licencën që leshohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, gjë që nuk e dëshmon se Gjeodeti mund të ushtron veprimtarinë e tij pa licencë.

Neni 6 Kompanitë dhe gjeodetët e licencuar - Ligji 04/L-013 konkretisht Neni 6 1.

AKK-ja licencon kompanitë gjeodete dhe gjeodetët për kryerjen e matjeve kadastrale bazuar në këtë ligj. **Pra, gjeodeti në dosjen e prezantuar nga OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar sepse nuk ka licence sipas Ligjit 04/L-013.**

Pra, nuk mund të ushtroj funksion pa qene i licencuar.

Pretendimi ankimor nr.5

OE është i papergjegjshëm sepse të vlerësimi i rriskut nuk e disponon Licencën e kompanisë që e ka certifikuar për vlerësim të rriskut.

Tek kriteri i kërkuar për vlerësim të rriskut sipas Ligjit 04-L-161, AK ka kërkuar Raportin e vlerësimit të rriskut nga një kompani të licencuar ku OE nuk e ka dhënë licencën, dhe kjo bën në dyshim se ka marrë vlerësim të rriskut nga një kompani që nuk dëshmon se është e licencuar nga MPMS.

Pra, AK nuk i ka kërkuar sqarime sipas nenit 72 të LPP-se.

AK ka shkelur nenin 61 të LPP-se sepse OE i rekomanduar ka cmime jo-normalisht të ulëta sipas nenit 61 të LPP-se dhe Rregullores për cmime jo normalisht të ulëta, ku në dy pozicione

Poz.3.1 ka cmim 3.80 €, dhe

Poz. 3.2 ka cmim 4.80 €

| | | | | | |
|-----|--|----------------|-----------|------|-----------|
| 3.1 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (70MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror, 0-60mm me trashësi t=20cm | m ³ | 16,044.80 | 3.80 | 60,970.24 |
| 3.2 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (90MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror, 0-31mm me trashësi t=10cm | m ³ | 8,701.00 | 4.80 | 41,764.80 |

Pra, si është e mundur me këto cmime të ekzekutoj punimet ku këto janë cmime jo normalisht të ulëta, sepse nësi prodhues Mirusha Company kemi cmime të cilat janë cmime të tregut sepse kostoja e prodhimit nuk lejon të del nën cmimet e ofertuara sic jemi në, andaj OE i rekomanduar ka bërë mashtrim apo ka vendosur cmime jo reale, sepse cmimet reale nësi prodhues dhe ofertat të cilat kryejmë furnizime dhe shërbime të përditshme të kësaj natyre janë afro 100% më të shtrenjta se cmimet e OE se rekomanduar.

Ku cmimet tona për këto dy pozicione janë:

| | | | | | |
|-----|--|----------------|-----------|------|-----------|
| 3.1 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (70MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror, 0-60mm me trashësi t=20cm | m ³ | 16,044.80 | 6.00 | 96,268.80 |
| 3.2 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (90MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror, 0-31mm me trashësi t=10cm | m ³ | 8,701.00 | 8.00 | 69,608.00 |

Ku për keto pozicione në si OE ofertues ua prezantojmë edhe faturat e paguara për 1 m³ zhavorr 60 mm, dhe 31 mm, e jo të pranohen oferta të cilat janë mashtruese sepse të gjithë e dijmë se sa është 1m³ zhavorr 60 mm dhe 31 mm.

Pra, në po ua dëshmojmë me dëshmi të bankës të cilat i kemi paguar dhe jo oferta dyshuese të lëshuara. Pra, sipas LPP-së dhe Rregullave për tender jo-normalisht le ulet oferta e tij është e papërgjegjshme edhe në këtë pikë

Pra, kjo është ben të papërgjegjshme OE "Kema Company"- Lipjan, për arsye se nuk i plotëson kriteret e kërkuara të FDT-së dhe poashtu ka cmime jo-normalisht të ulëta sipas nenit 61 të LPP-së dhe Rregullave për Tender jo-normalisht të ulët Neni 4 - Procedura e shqyrtimit (*inter partes*).

Pretendimi ankimor nr.6

AK ka bërë shkeljen e nenit 60 të LPP-së sepse ka shpërblyer me kontratë OE i cili nuk e plotëson kriterin e kërkuar si në nenin 1.1 të nenit 60 të LPP-së. Tenderi i Përgjegjshëm me cimmë me të lirë. Pra, gjatë rivlerësimit të bëjë korrigjimin dhe të na shpërblejë neve me kontratë sepse i përmbushim të gjitha kriteret e kërkuara sipas FDT-së dhe NjK-së.

Andaj Oferta jone është e përgjegjshme sepse si OE i plotësojmë kriteret e kërkuara në FDT dhe Njoftim për kontratë *Kërkojmë nga OSHP që të marrë :*

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE "Quality Asphalt" SHPK - Ferizaj
Të DETYROHET, AK që të bëjë kthimin e lëndës në rivlerësim

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

3. OE duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit 04 L-161 për Siguri dhe Shendet në Pune - për loton e I-re, ndërsa për lotot tjera nuk aplikohet.

DESHMIA DOKUMENTARE

Operatorët Ekonomik duhet të dëshmojnë raportin e vlerësimit të rriskut për të gjitha pozitat e organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e licensuar nga Ministria e Punës dhe Mireqenjes Sociale

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratë të ngjashme, punë, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej Loto 1. 1.600.000,00 euro Loto 2. 100.000,00 euro Loto 3. 200.000,00 euro Loto 4. 200.000,00 euro Loto 5. 300.000,00 euro Loto 6. 200.000,00 euro Loto 7. 550.000,00 euro Loto 8. 150.000,00 euro
2. OE-ik duhet të ofrojë dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon o Udhëheqës i punishtës - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë (Menaxher i Projektit) – **min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit** (drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë). Udhëheqësi i punishtës duhet të ketë udhëhequr së paku 2 (dy) kontratë në vlerën e parashikuar.- për Loton I dhe VII-te. o Udhëheqës i punishtës - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë (Menaxher i Projektit) – **min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit** (drejtimi konstruktiv

ose infrastrukturë). Udhëheqësi i punishtes duhet të ketë udhëhequr së paku 1 (një) kontratë në vlerën e parashikuar.- për Loton II,III,IV,V,VI dhe VIII-te. o Një (1)inxhinier ose bachelor i diplomuar i gjeodezisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot. o Dy (2) Inxhinier ose bachelor të ndërtimtarisë (konstrukti ose infrastrukture) me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot. o Një (1) inxhinier i diplomuar i hidroteknikës me më së paku dy vite përvojë pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i hidroteknikës me më së paku dy vite përvojë pune pas diplomimit – Për të gjitha Lotot. o Një (1) inxhinier i diplomuar i komunikacionit me më së paku dy vite përvojë pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i komunikacionit me më së paku dy vite përvojë pune pas diplomimit - Loto I,III,IV,V,VI, dhe VII. - Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi për min. 30 punëtorë të paraqitur në administratën taimore në tre vitet e fundit për - vetëm për LOT 1.

3. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.
4. OE duhet të ketë Baze për Prodhimin e asfaltit në Pronesi apo marrvëshje për furnizim me asfalt - për të gjitha Lotot
5. OE Duhet të ketë Gurethyes të licensuar në Pronesi apo marrvëshje për furnizim me zhavor - Për të gjitha Lotot
6. OE Duhet të ketë Baze për prodhimin e Betonit në Pronesi apo marrvëshje për furnizim me beton Për të gjitha Lotot

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 Lote, shuma më e lartë e vlerës së kontratave të realizuara që kërkohet për Lotet për të cilat konkurrenca duhet të përmbushet nga OE. Shëmbull Nëse OE vendos që të konkurrojë në Lot 1 dhe 2, atëherë kërkesa minimale e punëve të realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE është 1,600,000.00 euro. nëse OE vendos që të konkurrojë në Lot 2 dhe 3, atëherë kërkesa minimale e punëve të realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE është 200,000.00 euro
2. Për inxhinieret e kërkuar duhet dëshmuar CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrvëshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lemin e kërkuar të leshuar nga punëdhënësi për menaxherin e projektit, ndërsa për punëtorët e paraqitur në administratën taimore të Kosovës, deklarata nga OE se posedon 30 punëtorë të paraqitur në ATK
3. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen, ndërsa për automjetet që regjistrohen duhet dëshmuar me Librezat e qarkullimit. Në rastet kur OE ka marrvëshje për shfrytëzimin e automjeteve, OE duhet të dorëzojë edhe marrvëshjen për shfrytëzim të automjeteve.
4. Kopja e licences e vlefshme të leshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur OE ka marrvëshje për furnizim, OE duhet të dorëzojë edhe kopjen e marrvëshjes për furnizim.
5. Kopja e licences e vlefshme të leshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur OE ka marrvëshje për furnizim, OE duhet të dorëzojë edhe kopjen e marrvëshjes për furnizim.
6. OE Duhet të ketë Baze për prodhimin e Betonit në Pronesi apo marrvëshje për furnizim me beton Për të gjitha Loto.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Quality Asphalt" SHPK - Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: 858/19, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse", me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, (Lot 1), iniciuar nga AK – Komuna Prishtinë.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

AK, per lot 1, ka rekomanduar OE “Kema Company” shpk

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA.

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtine, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës në lotin 1 pas ri vlerësimit të ofertave.

Përgjigjeje në pretendimin ankimor (neni 113): Fillimisht po sqarojmë se loti 1 i këtij aktiviteti të prokurimit ka qenë objekt shqyrtimit në OSHP, rrjedhimisht disa nga pretendimet ankimore tani me i kemi trajtuar, *po ashtu* edhe paneli shqyrtues përmes vendimit me nr. **858/20**, të datës **16.11.2020**, kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar aneksen e OE “Sallahu” shpk – Prishtine, ku përmes arsyetimit të të njëjtit vendim është obliguar AK – Komuna Prishtine, që të kërkohej sqarime shtese sipas nenit 59.2 dhe 72, të LPP-se.

- Sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt stafit dhe përvojës së tyre, AK – Komuna Prishtine përmes procesit të rivlerësimit, me datën 03.12.2020, ka kërkuar sqarime shtese nga operatori ekonomik edhe tani i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar përgjigje, të cilat e kanë bindur AK-ne.
- Pretendimi tjetër lidhur me **licencën** e kompanisë e cila ka vlerësuar *riskun*, sqarojmë se AK, përmes dëshmisë dokumentare të pozicionit nr. 3, të përshtatshmërisë profesionale, nuk ka kërkuar nga OE-te të prezantojnë licence si dëshmi. Është kërkuar të dëshmohet raporti i vlerësimit të riskut për të gjitha pozitat e organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga MPMS. OE i rekomanduar ka, prezantuar raportin i cili është vulosur nga kompania B&M shpk- Ferizaj, rrjedhimisht AK, e ka trajtuar si kompani të licencuar.

- Pretendimi tjetër ankimore që ka të bëjë me çmimet jo normale, kontestohen pozicionet 3.1 dhe 3.2, të OE të rekomanduar për dhënie. Sipas nenit 61, të LPP-se, përgjegjësia e çmimeve jo normale bie mbi AK-ne, rrjedhimisht nëse duken apo ekzistojnë çmime jo normalisht të ulëta AK, kërkon sqarim nga ofertues.

Përfundimisht sipas asaj që u përshkrua si më lartë, përkatësisht sipas dispozitave të nenit 108/A, operatori ekonomik ankues nuk i ka aplikuar procedurën e ankimimit komfor dispozitave ligjore. Paragrafi 3.2, i të njëjtit nën qartë sqaron rastet e kontestimit apo ankimimit të njoftimit për dhënie të kontratës “në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit”.

Si prova shkresore se bashku me raport gjeni kopjet:

Kërkesa për sqarim;

Përgjigjen kundrejt kërkesës;

Pjesë nga raporti i vlerësimit të riskut.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, vendimit paraproak të PSH-se dhe procedurës së prokurimit, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **hudhet si e pa lejuar**.


Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues
- Panelit Shqyrtues
- OE ankues
- Komuna Prishtin.
- OSHP.
- “Quality Asphalt” shpk - Ferizaj.

Kodi i dokumentit 06-18-MCB&M

VLERËSIMI I RISKUT PËR POZITAT E PUNËS NË KOMPANIN

Kema - Company SH.P.K. / QMI - Prishtinë



Kodi Referues i Dokumentit:

06-18-MCB&M

Rishikimi:

0

Data e lëshimit:

27.12.2019

Përgatitur nga:

B&M SH.P.K
1.Rruga e Reçakut Nr. 10/Ferizaj

Pranuar nga:

[Handwritten signature]



4. DEKLARATË PËR SIGURI DHE SHËNDET NË VENDIN E PUNËS

| | | | |
|---|-----------------------------------|---------------------------|------------------------------------|
| Data e lëshimit | 27.12.2019 | Data e rishikimit | |
| Të dhënat për personat e Punëdhënësit të cilët kanë marrë pjesë në vlerësim | Emri dhe Mbiemri Burhan Kolshi | Vendi i punës Menaxher | Përgatitja profesionale E mesme |
| Vendi i punës | Punëtor në prodhimin e Kubzave | | E mesme |

| | | | | |
|---|---|-----------------------------|---------|--|
| Numri i të punësuarve në vendin e punës | 2 | Niveli i vlerësuar i Riskut | I ulët | Pikat: 3, 10, 22, 23, 26 |
| | | | I mesëm | Pikat: 1, 2, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 24, 26 |
| | | | I lartë | Pikat: 4, 15 |

Të dhënat për personat profesional për SSHP

Minir Curri. ing. i mak. çert. Nacionale nr.: 01/2017. Çert. ndërkombëtare NEBOSH CG300237298/61 1444

Jetmir Rogaqi ing. i mak. MSC në emergjenca, Çert. Nacionale nr.: 19. Çert. ndërkombëtare NEBOSH nr.: GC300254645/672587

Vehap Curri ing i elektr. MSC në mekatronikë, Çert. Nacionale: nr. 59. Çert ndërkombëtare NEBOSH nr.: GC3/00254620/671964

Personi i autorizuar profesional për SSHP

Minir Curri (udhëheqës i ekipit)

Punëdhënësi

Obligohem se:

Me përgjegjësi juridike dhe morale siguroj se do të marr të gjitha masat për zvogelimin e riskut në këtë vend pune të konstatuara nga ky elaborat siq vijon:

- ✓ Do të siguroj zbatim të gjitha masave për siguri dhe shëndet gjatë punës të cilat janë paraparë me Aktin për vlerësim të rrezikut në vendin e punës dhe mjedisin e punës në kompani;
- ✓ Do të siguroj kontrollë të zbatimit të masave të parapara;
- ✓ Do të ngre procedurë për ndryshimin dhe plotësimin e Aktit për vlerësim të rrezikut në pajtueshmëri me rregullat ligjore;
- ✓ Në kohë dhe plotësisht do të informoj të punësuarit për rreziqet;

Kërkesa për sgram 03.12.20

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 - PRISHTINË

Grup i Operatorëve Ekonomik Kema - Company Sh.p.k.; Pro & Co
Group SH.P.K., Te QMI-a, -, LIPJAN, Kosovë

| | |
|-------------------|-------------------|
| Nr. i prokurimit: | 616-20-2390-5-1-1 |
| Nr i brendshëm | 616 20 039 511 |

Titulli: Ndërtimi i rrugëve ne pjesët rurale me infrastrukture përcjellëse

I/e nderuar: Blerim Kolshi

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

1 Ne Dosjen e tenderit ne piken 9.1&9.2 te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale njëra prej pikave janë kërkuar edhe

- **Dy (2) Inxhinier ose baçelor te ndërtimtarisë (konstrukti ose infrastrukture) me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot dhe**
- **Një (1) inxhinier I diplomuar i komunikacionit me më se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i komunikacionit me më se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit - Loto I, III, IV, V, VI, dhe VII.**

